

VENDIM
Nr.27, datë 11.12.2006

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, më datë 2. 6.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.26 Akti, që i përket:

KËRKUES: ARBEN DERVISHI, përfaqësuar nga avokatët Qazim Gjonaj e Baftjar Rusi, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: PROKURORIA E PËRGJITHSHME, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve nr.151, datë 14.7.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; nr.334, datë 3.11.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr.764, datë 9.11.2005 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi pretendon se gjykatat i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, duke arsyetuar në këto drejtime kryesore:

Së pari, në fazën e hetimit nuk i është komunikuar akuza. Janë lejuar një sërë veprimesh procedurale pa praninë e mbrojtësit, si e drejta për informim të menjëhershëm për thelbin dhe shkakun e akuzës, parashikuar nga nenet 28/1 dhe 31/a të Kushtetutës, si dhe neni 6/3 shkronja “e” e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Së dyti, prokurori ka shkelur të drejtën e njoftimit, sepse sipas nenit 140/1 të Kodit të Procedurës Penale, meqenëse nuk ishte marrë masë ndalimi apo arresti, duhej të zbatoheshin rregullat e njoftimit të pandehurit të lirë.

Së treti, prokura e lëshuar në emër të kërkuesit për përfaqësimin në gjykim nuk është nënshkruar prej tij, për arsye se ai ka qenë në Greqi. Në këtë prokurë rezulton se i pandehuri ka pranuar fajësinë, akuzën, si dhe mbrojtësin, në kundërshtim me interesat e tij. Prokura nuk është sipas formës ligjore, pasi i mungon edhe vula e thatë.

Së katërti, mungesa e njoftimit për të pandehurin ose familjarët e tij në gjykimin në gjykatën e rrethit gjyqësor dhe mungesa e njoftimit për ankimin e prokurorit dhe për datën e gjykimit në apel, kanë shkelur të drejtën e mbrojtjes.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesin e kërkuesit dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka deklaruar fajtor kërkuesin për veprën penale të shfrytëzimit të prostitucionit, parashikuar nga neni 114/a, pikat 4 e 5 të Kodit Penal, duke e dënuar me 10 vjet burgim dhe në aplikim të gjykimit të shkurtuar me 6 vjet e 8 muaj burgim.

Gjykata e Apelit Vlorë ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor për fajësinë dhe

kualifikimin e veprës penale, por e ka dënuar të pandehurin me 8 vjet burgim duke urdhëruar zbritjen e 1/3 së dënimit.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë.

Megjithëse nga pikëpamja formale pretendimet e kërkuarit lidhen me disa nga elementet e procesit të rregullt ligjor, Gjykata Kushtetuese i shqyrtoi ato në seancë gjyqësore dhe konkludoi se janë të pabazuara. Pretendimet e kërkuarit për moskomunikimin e akuzës dhe për mosqenien e tij apo të mbrojtësit në dijeni të zhvillimit të procesit ligjor në gjykatën e rrethit gjyqësor dhe në gjykatën e apelit, nuk qëndrojnë. Nga verifikimi i dosjes gjyqësore rezultoi se mbrojtësi i caktuar prej kërkuarit ka qenë i pranishëm në të gjitha veprimet procedurale si në fazën e hetimit ashtu edhe në atë të gjyqimit.

Pretendimi i kërkuarit për falsitetin e prokurës së hartuar para noterit, të cilën e bazoi në një akt ekspertimi privat të paraqitur në seancë gjyqësore, nuk është i bazuar. Nga dosja rezultoi se prokura, nëpërmjet të cilës është autorizuar mbrojtësi për të realizuar përfaqësimin në gjykim të kërkuarit, është e nënshkruar prej këtij të fundit. Përderisa, në rastin konkret, ndodhemi përpara një akti publik të nënshkruar para noterit dhe që prezumohet i ligjshëm, i binte barra kërkuarit që, konform rregullave procedurale, të provonte përfundimisht në instancat gjyqësore pasaktësinë apo pavërtetësinë e këtij dokumenti zyrtar. Duke iu referuar një akt ekspertimi të siguar nga vetë kërkuari, Gjykata Kushtetuese nuk mund të investojë mbi falsitetin e prokurës dhe për rrjedhojë për parregullsinë e të gjithë procesit ligjor.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese konkludon se, përderisa kërkesa e paraqitur nga kërkuari nuk provon se procesi ligjor i zhvilluar ndaj tij të ketë shkelur parimet thelbësore të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duhet rrëzuar si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronja “f” dhe 134 pika 1 shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.